



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT *l.p.*

DPSUMK

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr. 2, Tiranë

Tel/Fax : +4 259 333

Nr. 2413 Prot.

Tiranë, më 26.5 2006

URDHËR

Nr. 2413 Datë 26.5 2006

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES " PËR KRYERJEN E KONTROLLIT
SHTETËROR TË PRODUKTEVE USHQIMORE" .

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, dhe nenit 29, 30, 31 dhe 41 të ligjit nr. 7941 dt. 31.05.1995 "Për Ushqimin"

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores " Për kryerjen e kontrollit shtetëror të produkteve ushqimore" bashkëlidhur këtij Urdhëri .
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithëshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij Urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

JEMIN GJANA

Drejtoria e Përgjithëshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

RREGULLORE

PER

KRYERJEN E KONTROLLIT SHTETEROR TE PRODUKTEVE USHQIMORE.

Neni 1

Qellimi

Kjo rregullore percakton parimet e pergjithshme mbi kryerjen e kontroleve shteterore te produkteve ushqimore. Ajo ka per qellim parandalimin e rreziqeve per shendetin publik, garantimin e besueshmerise ne tregti si dhe mbrojtjen e interesave te konsumatoreve, perfshire ketu informimin e tyre rreth problemeve te sigurise ushqimore. Kjo rregullore nuk zbatohet ne kontrollin metrologjik.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Kontrolli zyrtar do te kryhet per te gjitha produktet ushqimore te prodhuara ne vend, per konsum ne tregun e brendshem apo eksport, si dhe per produktet e importuara. Ky kontroll gjithashtu do te perfshije aditivet ushqimor, vitaminat, kriperat minerale, mikroelementet si dhe aditive te tjere qe shiten si te tille, materialeve dhe lendeve ne kontakt me ushqimet.

Neni 3

Perkufizime

Per qellim te kesaj rregulloreje, termat e meposhtem kane kete kuptim:

1. "Kontrolli shteteror i produkteve ushqimore.. kupton kontrollin nga inspektoriati ushqimor i kontrollit, te pershtatshmerise per konsum njerezor, te produkteve ushqimore.
2. Sistemi i verifikimit, kupton sistemin e verifikimit te procedurave te dokumentuara te mbajtura ne te gjitha hallkat e prodhimit.

Neni 4

Inspektori

1. Personat e autorizuar per inspektimin e produkteve ushqimore, inspektoret, duhet te kene arsimin e larte universitar:

- Kimi
- Mjeksi veterinarë
- Teknologji ushqimore
- Agronomi

2. Inspektori duhet të ketë eksperiencë punë në industrinë ushqimore, të jetë korrekt dhe i aftë për kryerjen e detyrës pa paragjykimë.

3. Inspektoret e kontrollit ushqimor janë të detyruar të ruajnë sekretin profesional për kontrollet e kryera.

Neni 5

Parimet e përgjithshme të kryesjes së inspektimit

1. Inspektimi kryhet :

- a- Rregullisht , sipas një plani mujor të përgatitur
- b- kur dyshohet që ushqimet janë të papërshtatshme për konsum njerezor.

2. Inspektimet bëhen duke përdorur menyrë të përshtatshme dhe të verifikueshme.

3. Inspektimi i ushqimeve bëhet në pikat e inspektimit kufitar dhe në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit, magazinimit, transportit, shpërndarjes dhe tregtimit.

4. Inspektimi si rregull i përgjithshëm bëhet pa paralajmërim.

5. Si rregull i përgjithshëm, për kryerjen e inspektimit, zgjidhet faza apo fazat më të përshtatshme sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të këtij neni.

Neni 6

Kontrolli shtetëror i produkteve ushqimore

Kontrolli bëhet sipas kushteve të përcaktuara në nenet 7 deri në 10 të kësaj rregulloreje dhe përfshin:

1. Inspektimin
2. Marëjen e mostrave dhe analizimi i tyre.
3. Inspektimi i higjenes
4. Kontrollin e dokumentacionit të prodhimit dhe tregtimit të produktit ushqimor.

5. Kontrollin e sistemit të verifikimit dhe auto- kontrollit të cilësisë ngritur nga subjektet prodhuese dhe rezultatet e arritura.

Neni 7

Inspektimi

1. Inspektimi përfshin:
 - a. Fazat e ndryshme të përmendura në pikën 3. neni 5 të kësaj rregullore si dhe ndertesat, zyrat, objektet përreth, mjetet e transportit, makineritë dhe pajisjet.
 - b. Lëndet e para, perberësit, shtesat teknologjike, materialet paketuese dhe produktet e tjera të përdorura për përgatitjen dhe prodhimin e produkteve ushqimore.
 - c. Produktet gjysem të gatshme
 - d. Përberjen e produktit të gatshme
 - e. Materialet dhe lëndet që bien në kontakt me produktet ushqimore.
 - f. Materialet dhe proceset e pastrimit të mirëmbajtjes dhe pesticidet.
 - g. Teknologjinë dhe proceset e zbatuara për përpunimin dhe prodhimin e produkteve ushqimore
 - h. Etiketimin dhe marketimin e produkteve ushqimore .
 - i. Metodatat e ruajtjes, kushtet higjieno - sanitare të ruajtjes dhe tregëtimit.
2. Inspektimet e përshkruara në pikën 1 të këtij neni, sipas rastit, mund të plotësohen nga:
 - Intervistat me drejtorin e ndërmarrjes së kontrolluar dhe persona të tjerë që punojnë në atë ndërmarrje.
 - Verifikimi i vlerave të regjistruara nga instrumentet matëse të vendosura në ndërmarrje
 - Kontrollat e realizuara nga inspektorët me instrumentet e tyre matëse.

Neni 8

Marrja e mostrave

1. Gjate inspektimit sipas germave (b) deri në (f) të pikës 1 të nenit 7 merren mostra për qëllim analize sipas legjislacionit në fuqi.
2. Mostrat e marra sipas pikës 1 analizohen në laboratorët shtetërorë të ushqimeve.
3. Subjektet prodhuese duhet të mundësojnë marrjen e mostrave në sasinë e nevojshme nga inspektorët që kryejnë kontrollin.

Neni 9

Laboratoret shteterore te kontrollit dhe te references

- 1.Laboratoret shteterore rajonale dhe te Bashkive duhet te permbushin kushtet e percaktuara ne Praktikat e Mira Laboratorike.Laboratoret e references duhet te permbushin kushtet e percaktuara nga standartet perkatese. Standartet Europiane EN 45001,45002,45003.
- 2.Metodat per analizimin e mostrave te marra gjate kontrollit te produkteve ushqimore duhet te jene konform standardeve kombetare dhe nderkombetare.

Neni 10

Kontrolli i higjenes

Personat te cilet, gjate ushtrimit te aktivitetit te tyre jane ne kontakt direkt ose indirekt me produktet ose materialet e permendura ne nenin 7 (1) b deri f i nenshtrohen kontrollit higjenik.Ata jane subjekt i kontrollit te higjenes te percaktuar ne nenin 6 (3) ne lidhje me standartet shendetesore te higjenes personale dhe te veshjeve.

Neni 11

Dokumentacioni i kontrollit

1. Inspektoret e kontrollit te ushqimit mbajne aktin e kontrollit ne tre kopje dhe informojne rregullisht Kryeinspektorin e Inspektoriatit te Kontrollit te Ushqimit, i cili nga ana e tij, informon rregullisht ne drejtorine perkatese ne Ministrine e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit.
2. Inspektoret e kontrollit te ushqimit kerkojne egzaminimin e librave, dokumentave dhe shenimeve te tjera, te mbajtura nga subjekti, qe ai mendon se permban informacion te rendesishem. bejne kopje ose nxjerrin ekstrakte te dokumentave te paraqitur gjate kontrollit.

Neni 12

Masat e pergjithshme

Kur inspektori i kontrollit te ushqimit dyshon ose zbulon parregullsi(moszbatim te akteve ligjore dhe nenligjore per ushqimin) , merr masa te menjehereshme per eliminimin e tyre dhe informon Drejtorine perkatese ne Ministrine e Bujqesise,Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit.Per shkelje te dispozitave te ligjit Nr. 7941 dt. 31.05.1995 , inspektori ka te drejte te ndeshkoje personat fizike dhe juridik pergjegjes ne perputhje me Kreun VIII te Ligjit “Per Ushqimin”

Neni 13

Personat fizike dhe juridik janë të detyruar që jo vetëm të inspektohen në përputhje me këto rregullore por dhe të ndihmojnë inspektorët e kontrollit të ushqimit të kryejnë detyrën e tyre.

Neni 14

Ankimimi

Personat fizike dhe juridikë të cilët i nënshtrohen inspektimit, kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim, brenda 5 ditëve të drejtuesi i organit të kontrollit në qark ose të drejtori i drejtorisë përkatëse në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.